



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**  
**Kuvendi i Komunës**  
**-Kryesuesi i Kuvendit-**

**01Nr. 060/01-29425/24**  
**Kaçanik, 20.11.2024**

### **FTESE PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 29.11.2024 (e premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli

---

Në mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 29.11.2024 do të shqyrtohet ky:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (parë) e Jashtëzakonshme e KK, të datës 22.10.2024;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X (dhjetë) e Rregullt e KK, të datës 30.10.2024;
3. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025;
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;
5. Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal of Kacanik**

**01Nr. 060/01-26930/24**  
**Kaçanik, 22.10.2024**

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **I (parë)** e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 22.10.2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 17 anëtarë. Në mbledhje munguan pa arsye 10 anëtarë: Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Burim Shehu, Naim Beça, Ernesta Krasniqi, Bashkim Luma, Arta Avdiu, Betim Shala, Arlinda Rakoci-Raka, Agim Çaka.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi-DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Makfire Malsiu, Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e I (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, data 22.10.2024, me këtë:

### **REND PUNE**

1. Propozim Vendimi për transferin-harmonizimin e mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, për vitin 2024.

Rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

### **Aprovoj**

**Rendin e punës prej 1 pike.**

Kalojmë në shqyrtimin e pikës:

1. Propozim Vendimi për transferin-harmonizimin e mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, për vitin 2024.

Qëllimi i thirrjes së kësaj mbledhje është se mund të kemi vonesa në paga, kështu për me i anuluar këto, kjo ka ardhur si rezultat e procedurave përmbartimore, të cilat kanë prekur edhe kategorinë e pagave. Kjo seancë është thirrur me kërkesë të drejtorit, për harmonizim të programeve që mos të ndodhin vonesat e tilla, kështu po ia jap fjalën drejtorit të DBF, Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi:** Përkundër faktit se ne e kemi bërë planifikimin buxhetor edhe për paga, por ashtu siç e potencoj edhe kryesuesi, është kontrata kolektive në arsim që kanë filluar lëndët përmbartimore me u ekzekutuar. Jo si komunat tjera, në komunën tonë shuma prej 158 mijë euro është ekzekutuar sivjet, ka edhe shuma tjera kanë me u ekzekutuar, tani ka krijuar minuse të disa programe buxhetore. Vlerësimi të nën programet apo të drejtoritë është të arsimi fillor i mesëm i ulët, shuma prej 85 mijë euro, minus kemi të zjarrfikësit shuma 45 mijë euro, që nuk dalin mjetet për tetor, nëntor, dhjetor. Ndarja buxhetore për paga është e mjaftueshme, ne veç kemi marrë disa shuma të pagave në disa drejtori, për me i plotësuar këto drejtoritë tjera. Kemi marrë mjete në 10 nën programe buxhetore për me i plotësuar programet tjera. Të Zyra e KK, janë marrë 1,500.00€, DBF, shuma 2,500.00€, Infrastruktura rrugore, 10,000.00€, Bujqësia 6,700.00€, pylltaria 8,800.00€, Administrata e arsimit 9,000.00€, Arsimi para fillor 18,000.00€, Arsimi i mesëm i lartë 35,000.00€, Shërbimet kulturore 8,000.00€, Shërbimet shëndetësore 38,100.00€. Krejt këto i kemi dërguar të nën programet ku nuk ka mjete si: Administrata e shëndetësisë, 1,000.00€, Çështjet gjinore 450.00 €, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, 500.00€, Shërbimet sociale 5,640.00€, Zjarrfikësit dhe inspektimet 45,000.00€, Arsimi fillor i mesëm i ulët shuma 85,000.00€. Këtë vendim pasi të miratoni dhe pas analizave që janë bërë, nuk do të ketë nuk do të ketë mungesë të pagave të asnjë program buxhetor dhe nuk do të rrezikohet asnjë i punësuar në pagë në komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Duke ditur kjo seancë e jashtëzakonshme pse është thirrur, ne LDK të vetëdijshëm për përgjegjësinë që e kemi, për të cilën na kanë angazhuar qytetarët dhe na kanë besuar, sot jemi prezentë për me dëshmuar gatishmërinë tonë për me përkrahur gjithsecilin punëtorë që merr nga thesari i shtetit mjete dhe e kalon muajin me to. Ne jemi mos me u rrezikuar paga e askujt, ne jemi këtu edhe për me dhënë kritikën tonë, se unë e kam shprehur shqetësimin tim edhe në muajin e kaluar rreth kësaj problematike rreth ekzekutimit të pagave të çështja e kontratës kolektive, shqetësim ky të cilin e kam shprehur edhe në KPF, ku është përgjigjur drejtori edhe kryetari. Kjo është barrë e madhe për secilën komunë, pavarësisht nga kush udhëhiqet, është barrë që bie edhe të secilin anëtarë të KK. Unë shpresoj që niveli qendror me reflektuar me ua hequr këtë barrë komunave, se ju ka ra kjo përgjegjësi. Shpresoj në rishikim të buxhetit 2025, pavarësisht se është vit zgjedhor, me u bërë të gjithë bashkë dhe me votuar për ekzekutimin e mjeteve sipas kontratës kolektive. Shpresoj që duhet me gjetur unitet, kur kemi të bëjmë me atë se për çka jemi të thirrur, se ndonjëherë jo gjithçka është politike, e që sot mendoj se është ai moment. Nuk e di cili kishte me qenë arsytimi të palët tjera, meqenëse arsytimi mund të ketë, por po shpresoj që ti thirrëmi ndërgjegjes secili, që mos të na ndodh si komuna që mbetën pa paga arsimtarët. Nuk e di faji i kujt ka qenë, por nuk jemi ne ata që duhet t'i prijmë një çështje të tillë.

**z. Rrustem Zenuni:** E ceku edhe kolegia se është seanca e I e jashtëzakonshme e këtij viti, çështja për të cilën jemi thirrur, ne iu kemi përgjigjur pozitivisht ftesës për mbledhje. Këtë po e dëshmojmë edhe këtu, sepse qytetarët na kanë dhënë besimin që me qenë në shërbim të qytetarëve. Shpresoj mos të ketë probleme të kësaj natyre në të ardhmen.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë kjo pikë u shtrua në votim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 17. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për transferin-harmonizimin e mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, për vitin 2024/ Lënda: 01Nr. 060/01-26984/24.**

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:15. Nga 27 anëtarë sa ka KK, prezentë në këtë mbledhje ishin 17 anëtarë të cilët qëndruan këtë mbledhje deri në fund. Në mbledhje munguan pa arsye 10 anëtarë të KK.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit  
Kemal Murseli



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal of Kacanik**

**01Nr. 060/01-27044/24**  
**Kaçanik, 30.10.2024**

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **X (dhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30.10.2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht kur u lexua regjistri ishin 25 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari, Betim Shala dhe Hamide Luma, kështu që pjesëmarrjes të kësaj mbledhje janë 27 anëtarë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova-DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Fatlume Guri-Selimi, Mavije Murseli, Bejtulla Dalloshi. Makfire Malsiu.

Nga OSBE mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 30.10.2024, me këtë:

## **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti nëntëmujor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024;
3. Raporti i Përfundimit komunal për vitin 2023;
4. Informatë për përfundimin e Vitit Shkollor, 2023-2024;
5. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;
6. Kërkesa e MMPHI 6483-2/24 për Rishqyrtimin e Vendimit për miratimin e Planit të Veprimit në Mjedis me veprim klimatik i komunës së Kaçanikut 2024-2029 i datës 30.09.2024.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

**Aprovoj**

**Rendin e punës prej 6 pikave.**

## 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbalin i mbledhjes se kaluar të KK u aprovua me 18 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenime 7 nga LVV. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se kuvendi i Komunës pa vërejtje e,

### Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së IX(nëntë) të Kuvendit të Komunës, të datës 30.09.2024/  
Lënda: 01Nr.060/01-23705/24.**

### Pyetje dhe Kërkesa

**znj. Ardita Rrahmani:** Një pyetje qe përgjigje do te merr, e di por cili do të jetë përpilimi ende pa e parashtruar pyetjen po paragjykoj ne përfundim?

1. Qysh është e mundur që pothuajse ne secilin mandat qeverisës së paku nga një herë është “harrnuar” e ndërtua parku në hyrje të qytetit? Në një park hyrës të komunës, ku janë tre lapidarë ushtarësh, te mos ndërtohet një herë e pastaj të mirëmbahet, por veç prish e ndër vite, është turp përmbi turp. A do të bëhet publik projekti te cilin po e rindërtoni për te s’di satën herë dhe nëse po, kur sepse mbase nëse do e hidhni ne diskutim publik shumë me mirë kishte qenë para se të ndërmerrni hapa?

2. Tjetra, si është e mundur që çdo punë që fillon, deri në fund nuk shkon: Nënkalimi ende jo funksional. A keni ide se kush po shërbehet momentalisht aty? Ura tek shtëpia e kulturës gjysmake. Projektin e realizuar tek Ura e Konakut, Heqjen e çeshmës së çarshisë përkohësisht. Kur e keni vendosë me e rikthye aty ku ka qenë gjithmonë e me u shërbye qytetarët si gjithherë?

3. Banoret e lagjes “Emerllah Kuqi” ku janë diku mbi 15 shtëpi ne atë pjesë të rrugës, është mjerim se si e kalojnë rrugën çdo ditë, fëmijë, burra gra e pleq.

Ndriçimin ne Lagjen e Re - konkret në rrugën “Burim Rexha” e drejtim te Rushit Lutes, a janë prioritet dhe kur e mendoni ta vazhdoni. Po ashtu ne fshatin Ivajë- kur do te mbulohet me ndriçim publik ai fshat?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** 1. Në ligjëratën e organizuar për nderë të tetorit rozë, me këtë rast shfrytëzoj këtë foltore t’iu bëjë thirrje të gjitha grave dhe vajzave, që të vetëdijesohen dhe të bëjnë kontroll të rregullta kundër kancerit të gjirit. Në ligjëratën e cila u mbajt nën ligjërimin e QKMF dhe Zyrës për Barazi Gjimore, ndër të tjera, propozova që QKMF ka nevojë për një psikologe, e cila do të merret me gratë që janë me sfida të kancerit të gjirit. Kërkoj nga drejtori të merr përsysh këtë kërkesë, të shqyrtoj mundësinë për punësimin e një psikologu në QKMF.

2. Kam një pyetje për drejtorin e DA, në Komitetin për Politikë dhe Financa në mbledhjen e shtatorit, në pyetje që parashtrova se a është përmbushur numrin i asistenteve për fëmijë me nevoja të veçanta, përgjigja e juaj ishte se numri i paraparë është 11, ndërsa ju keni përmbushur vetëm 9 prej tyre. Kjo të bënë me kuptuar se janë edhe 2 vende të lira. A mundeni me urgjencë të rekrutoni një asistente për nxënësen në Gjimnazin “Skënderbeu”, për të cilën jeni njoftuar të gjithë?

3. Shprehi shqetësimin e qytetarëve dhe kërkesën, sa iu ka kushtuar ekskursioni i fundit në Turqi dhe cilat janë eksperiencat e ekskursioneve të viteve të kaluara që na keni sjellë këtu dhe a keni bërë ndonjë ndryshim gjatë këtyre eksperiencave? Nuk mund t’i justifikojmë askush ato shpenzime të larta, nëse përmendën këto tri vitet e fundit, i kemi këto shifra: në vitin 2022, 6,300.00€ nga taksat e qytetarëve të shpenzuara në Turqi, Në vitin 2023, 4,500.00€ taksa të qytetarëve të shpenzuara në Ulqin. Ndërsa viti i fundit bombastike, ku me para publike nuk

kishte mbetur kush pa marrë pjesë legjislativ, ekzekutiv, zyrtarë e deri të dy drejtorë të shkollave të mesme, ku taksat e qytetarëve shpenzohen e keqpërdorën në vlerë 14,000.00€. Si do t'i arsyetoni këto shpenzime para qytetarëve, që për 3 vite kapin vlerën 25,000.00€? Kur ne japim ide për mbështetje të nënave lehona me nga 100€, sikur komunat tjera, rritjen e vlerës së bursave për studentë dhe numrin e tyre, thoni se nuk kemi buxhet. Buxhet po keni me u shëtitur me taksa të qytetarëve prej drejtorit të shkollës e deri të kryetari. Me këtë rast kam një pyetje: Drejtorët e shkollave, a në bazë të performancës se suksesshme i keni përzgjedhur apo si, se kjo nuk është transparente karshi drejtorëve tjerë?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përgjigjen e jap unë për vizitën zyrtare.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kërkoj që përgjigja të epët me shkrim.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Është mirë kryesues përgjigjen me dhënë me shkrim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë po jap një konstatim. Me planin e punës së KK janë paraparë vizitat brenda dhe jashtë vendit. Vendimi për realizimin e vizitës zyrtare është marrë në KK. Kontrata ka qenë publike, jo e negociuar, jo qysh dinë partia e juaj dhe komunat e juaja me bërë. Shpenzimet janë shumë transparente dhe jo para gjepash qysh qeverisin partia juaj. Mundeni me shikuar raportet e auditorit i cili jep vlerësime për vizitat e komunave që qeverisin nga partia juaj. Janë vizita të ligjshme të komunës, parlamenti dhe qeveria e Kosovës kanë bërë edhe ligj të veçantë për bashkëpunim ndër komunal. Sa i përket rezultateve nga këto vizita, do të përshkruaj shumë shkurt: Jam shumë i kënaqur për pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë edhe për ata që na kanë pritur atje, qoftë nga komuna Osman Gazi, që na kanë pritur në ditën e parë, apo nga komuna Iznik e cila ka organizuar vizitën zyrtare në ditën e dytë. Shpejt kemi me pasur këtu në KK nismën për binjakëzim me komunën e Iznikut, për të cilën nismë nuk e di si keni me votuar, sigurisht kundër. Se shpejti do të keni edhe bashkëpunimet pse kanë qenë drejtorët e shkollave të mesme, në Iznik, për bashkëpunimin e shkollave Osman Gazi dhe Iznik. Sigurisht nuk iu bëjnë përshtypje këto, por unë personalisht i kam vizituar ato vende disa herë dhe është përgjegjësi dhe obligim për mua me marrë iniciativa të tilla. Ka qenë vendimi i KK që është marrë këtu, dikush ka votuar për, dikush kundër, kemi qenë të obliguar me përkrahur vullnetin e shumicës. Sa janë të frytshme këto vizita, mbetet me u pa. Nuk është komuna jonë e vetme që realizon vizita, janë të gjitha komunat e Kosovës, shumica me shpenzime shumë me të mëdha dhe me para në gjep, pa kontrata, kështu për këtë jam shumë i vetëdijshëm dhe shumë transparent dhe shumë i relaksuar në këtë drejtim, për arsye se çdo gjë është transparente dhe publike. A janë të frytshme apo, unë mendoj që nga vizita në Osman Gazi, ku kemi takuar kryetarin dhe zyrtarë tjerë të kësaj shkolle, për të cilët jam shumë falënderues edhe publikisht, pastaj vizita në Ermetal, me një përfaqësues nga Gjilani, i cili ka fabrika gjigande në Bursa dhe gati tërë ditën kemi qenë mysafirë të asaj familje, duke pa zhvillimin industrial të tij dhe mundësinë që ofron për të kryer praktika të nxënësve në fabrikën e tij. Mendoj se janë në dobinë tonë me pa zhvillimin dhe bashkëpunimin në këto fusha. Falënderoj edhe drejtorin e fabrikës, Faredin Gylener, i cili ishte një biznesmen shumë i fuqishëm dhe shumë i respektuar në komunën e Bursës. Vizita e dytë ka qenë Iznik në një qytet me shumë histori dhe shumë kulturë, me të cilën komunë kemi nisur iniciativat për bashkëpunim dhe binjakëzim të komunave, të cilat do të miratohen në kuvendet komunale. Dita e 3-të- vizita e monumenteve kulturore historike që i ka Turqia. Ditën e 4 kemi udhëtuar për Kosovë.

**z. Agim Çaka:** 1. Pyetja ime ka të bëjë me stërgjatën e projektit të çarshisë së vjetër, pyetje të cilën e kemi ngritur edhe në seancat e kaluara. Kur bëhet finalizimi i këtij projekti dhe si do të bëhet ndarja e lokaleve, a do të ketë kritere sipas bizneseve, cilat do të jenë kriteret?

2. Pyetja e dytë apo shqetësimi im, ka të bëjë me punët që kryhen në infrastrukturë rrugore, gjatë ndërhyrjeve në kanalizime apo në ujësjellës. Pas përfundimit të punëve, gjendja rrugore nuk kthehet në gjendjen fillestare, me ç' rast qytetarët ballafaqohen me problemin e shfrytëzimit të atyre rrugëve për qarkullim. Rastin konkret e kemi vite me radhë në rrugën e lagjes Çaka, ku me shpërthimin e gypave, është intervenuar disa herë, problemi nuk është zgjidhur përfundimisht dhe përsëri vijnë të njëjtat probleme. Pse nuk bëhet asfaltimi i asaj pjese të rrugës nga magjistralja deri të rruga e lagjes.

**3.** Pas të reshurave atmosferike që kishte para disa kohëve, u bë dëmtimi i përroskave, konkretisht përroi të lagjet: Çaka dhe Zeneli. A ka pasur ndonjë komision që ka bërë vlerësimin e dëmeve në këtë rast, të kjo përroskë dhe përroskat tjera, në mënyrë që shërbimet komunale të marrin masa për riparimin e tyre, që me kalimin e kohës dëmet mos të rriten tutje.

**4.** Në lagjen Koxhaj, ndriçimi publik nuk funksionon në tërësi apo funksionon me kapacitet 50%, gjysma e dritave janë jashtë funksionit që një kohë të gjatë. A e keni vërejtur këtë defekt? Nëse po, kur e keni në plan me rregullua?

**z. Agim Mani:** Fillimisht kryesues është mirë me respektuar fuqinë tonë politike, kur të ngritët dora, fjalën ta marrim ne si fuqi me e madhe opozitare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fuqia me e madhe është, fjala iu epët sipas paraqitjes.

**z. Agim Mani:** Nëse ngritëm dorën, fjala na jepet si fuqi me e madhe opozitare, kështu e thotë edhe ligji. Mendoj se kjo duhet me u respektuar. Ky është shqetësimi ynë, dhe kështu duhet të veprohet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë fjalën ia jap ia i cili e ngrit dorën i pari.

**z. Kadri Krivenjeva:** Ja jeni ju (LVV) të respektuar, nuk di se është kush me i respektuar këtu në KK.

**z. Agim Mani:** Kryesues ju e dhatë një rezymë, me të cilën vet i theve kriteret lidhur me përgjigjet në kërkesa. Asnjë përgjigje nuk është dhënë gojarisht, për çdo pyetje që kemi ngritur. Ju po i thyni vet parimet të cilat i keni vendosur. A do të japësh përgjigje me shkrim në pyetjen që u ngrit? Pyetja ishte e Kadrijës, Çka keni ofruar nga vizitat e mëhershme 2022 dhe 2023? Cila është përgjigje nëse mundësh me dhënë? Ndërkaq për vitin 2024, flasim në vitin 2025. Çka keni ofruar nga vizitat e vitit 2022 dhe 2023 që keni shpenzuar mjetet e qytetarëve, duke u shëtitur dhe nuk keni ofruar asgjë për komunën tonë?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në vendet e Shqipërisë, ka qenë vizita për këmbim të përvojave në vetëqeverisjes lokale, e keni parë titullin e kontratave. Në ato takime të gjithë ata që kanë qenë pjesëmarrës, që janë këtu e dinë. Është trajtuar fusha e vetëqeverisjes lokale, sesi funksionon vetëqeverisja lokale në Shqipëri, është pa sesi funksionon vetëqeverisja lokale në Mal të Zi, janë vendosur kontakte qoftë personale apo zyrtare me personat kyç të institucioneve të atyre komunave, dhe kjo ka qenë deri tani. Në Republikën e Turqisë, përveç kësaj, presim me shumë, për shkak se është shtet me i zhvilluar, presim të na ofroj në aspektin e zhvillimit profesional të arsimit, por edhe në fusha tjera të zhvillimit. Besoj se një delegacion kemi me pasur prej tyre këtu, sepse janë të interesuar për bashkëpunim me komunën tonë. Në çështjen që u cek për marrje të fjalës, është praktikë e mëhershme, ata të cilët e ngritin dorën, e marrin fjalën sipas paraqitjes.

**z. Rustem Zenuni:** Po ndërldhem me diskutimin për marrje fjalës, e kemi obligim si shumicë në KK, me i dhënë përparësi pakicës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Se qysh e mbajë rendin këtu, këto janë punë të mia.

**z. Naim Beça:** Me herët 2 anëtarë kërkuar pse nuk janë përfunduar disa nga projektet. Unë që 6 muaj rresht kam kërkuar sqarime pse nuk janë kryer projektet? Është mirë me pasur me shkrim përgjigjen, për projektet të cilat nuk janë përfunduar në komunën e Kaçanikut, se shumica nuk janë përfunduar. Nëse jepet një përgjigje me shkrim, atëherë nuk kishte pasur nevojë me ngritur pyetje të tilla, se e kishim kuptuar ne edhe qytetarët arsyet pse disa nga projektet nuk janë përfunduar, si rrugët, ura të ETC. Me pasur një përgjigje për të gjitha projektet të cilat janë nisur, por që nuk kanë përfunduar, kështu informohen qytetarët dhe nuk ka nevojë në mbledhjen tjetër me bërë të njëjtën pyetje. Unë 6 herë kam kërkuar, përgjigje nuk kam marrë asnjëherë. I kam 2 kërkesa prej qytetarëve të komunës tonë, dy janë të njëjta:

1. Vendosja e pengesave (policëve të shtrirë) të shkolla fillore, se automjetet lëvizin shpejt dhe kjo paraqet rrezik për fëmijët që kalojnë atypari.

2. Banorët e lagjes “Idriz Seferi”, kanë ankesa, se vozitja është tepër e shpejtë e automjeteve që vijnë nga rruga kryesore. Unë kam e pa gjendjen vet. Kërkoj të vendosen shenjat e komunikacionit për shpejtësinë e lejuar në atë pjesë? Rruga është shumë e ngushtë, për me ia lëshuar rrugën njëra tjetrës, veturat detyrohen të ngjiten mbi trotuar. Banorët e lagjes e shohin si rrezik permanent për fëmijët e tyre. Kërkoj të keni konsideratë këtë çështje dhe të vendosni barriera në atë rrugë.

3. Kam kërkesë nga banorët e lagjes “Ismail Qemali” që lidhë rrugën: “Ismet Jashari dhe Nexhmush Elezi”, për shkrimin me asfalt të asaj rruge me buxhetin e vitit 2025. Ajo rrugë ka qenë gjithnjë problem dhe është shumë e shkatërruar. Ajo lagje ka mbi 100 shtëpi, ata janë të gatshëm me ardhur me biseduar me kryetarin dhe mekanizmat tjerë përgjegjës, që me bërë një kërkesë me nënshkrime, që kjo rrugë me u shtruar me asfalt e jo me kocka siç është e shtruar, se po paraqet rrezik çdo herë për banorët e asaj lagjeje nga automjetet që qarkullojnë në atë rrugë, sidomos për fëmijët, se aty afër është një shesh i fëmijëve. Është mirë rruga të shtrohet me asfalt, dhe të rregullohet ujësjellësi dhe kanalizimi në atë rrugë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Sot po e ngriti një shqetësim jo vetëm timin por edhe të shumë qytetarëve, sesi po menaxhohet buxheti i komunës tonë, konkretisht për investimet e fundit që po bëhen. Gjatë këtij muaji po shohim se po investohen 140 mijë euro për parkun e qytetit, për të cilin është investuar edhe disa herë me parë. Një pyetje që dua t’ia adresoj kryetarit, kryetar, a iu ka thënë ndokush se ka ndonjë pasuri nëntokësore që po gërmoni aq shpesh, se në fund kjo nuk ka kuptim. Në vitin 2009 është rregulluar për herë të parë ky park, pastaj 2019 është bërë një investim rreth 270 mijë euro, e në këtë vit po investoni përsëri 140 mijë euro. Nëse bëjmë një përlllogaritje, nja 410 mijë euro brenda pak vitesh për një park, gati gjysmë milioni, që me këto mjete munden me u bërë shumë punë me të mëdha. Është e qartë se vizioni i juaj në të ardhmen është i kufizuar, është shumë i qartë se mungon vizioni afatgjatë. Projektet tuaja janë të kufizuara, dhe shkurt pamës, se nuk ofrojnë përfitime afatgjatë të qytetarëve. Në vend se të ndërtohet diçka për të ardhmen, ju thjeshtë po e riparoni të tashmen, duke humbur mundësinë për zhvillim real.

**Kryetari i Komunës:** Kjo nuk është pyetje, por ligjëratë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos u lëshoni në komente.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kjo ishte për parkun e qytetit, sa për komente, të dëgjuam kryesues 10 minuta. A janë këto projekte të mirë menduara sipas juve?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Bëni pyetjen e merr përgjigjen.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Sa duash foli dhe çka të dua. Nuk keni të drejtë me ma ndërprerë fjalën, se ma ndërpreve fjalën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mundesh me fol sa të duash, por jo çka të duash, e bënë pyetjen, mos u lësho në konkluzione. Nuk të ndërpresë fjalën, kur fol brenda asaj që duhet me folur.

**znj. Ardita Rrahmani:** E kam një pyetje, ka të bëjë me tenderin e ndërtimit të rrugës, Runjevë-Stagovë. Pasi projekti është në fazën ankimore në OSHP, nëse nuk arrihet të nënshkruhet kontrata, për arsye të anulimit të procedurës së prokurimit, a ka mjaftueshëm kohë me u ri tenderua ky projekt? Nëse nuk arrihet nënshkrimi i këtij projekti, a rrezikohen këto mjete, pasi që janë nga GP, mos të harrojmë njëherë e kemi humbur këtë projekt, mos të ndodhë edhe herën e dytë?

**z. Brahim Imishti:** Kam një kërkesë për opozitën, sa mirë po i elaboroni kërkesat, por a e dini se për këto kërkesa, qytetarëve të komunës së Kaçanikut nuk ia keni votuar buxhetin, nuk e keni diskutuar, bile edhe e keni lëshuar mbledhjen. Kjo është papërgjegjësi morale dhe etike me dal para qytetarëve me këto diskutime.

**znj. Ardita Rrahmani:** Për derisa me u drejtua mua, po flas në emër të LDK, se unë e përfaqësoj një grup politik, asnjëherë nuk i kemi ikur përgjegjësisë, kemi qëndruar këtu, por nuk na keni dhënë një arsye me votuar buxhetin, se asnjë kërkesë që e kam paraqitur qoftë në dëgjime publike apo në seanca të KK, nuk me keni miratuar. Për çka me ta votuar unë buxhetin ty, me ti bërë vijat e trasha të buxhetit. Një kërkesë e vetme e imja, nëse kishte hyrë në buxhet, e kisha votuar, se nuk vuaj asnjëherë prej kompleksit të opozitës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi në pozicionin pyetje dhe kërkesa. E ndërpresë këtu këtë çështje.

**z. Kadri Krivenjeva:** Çfarë kërkesë keni adresuar për buxhetin, që nuk të është miratuar?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk keni marrë pjesë në debate publike për buxhetin dhe nuk është e vërtetë që nuk janë përfshirë asnjë kërkesë për buxhetin, është dashur me marrë pjesë në debate publike për buxhetin. Një kërkesë nuk është përfshirë në buxhet, dhe atë po e përmendni. Buxheti i komunës përfshinë shumë projekte, besoj se ju nuk jeni kundër projekteve të përfshira në buxhet, mund të keni pasur ndonjë kërkesë që nuk është përfshirë, nuk ka pasur mundësi, kështu që pajtohemi me këtë pikë. Kalojmë në pikë e radhës:

## **2. Raporti nëntëmujor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024;**

Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Të Raporti financiar, ndryshimi në kategori dhe planifikim nuk janë të justifikueshme, përveç në raste të jashtëzakonshme, realizimi nuk është në përputhje me planifikimet që vet i keni bërë. Kjo tregon se ndarja e mjeteve nuk ka qenë e duhur dhe kjo tregon se ka keq planifikim të buxhetit. Plani i buxhetit duhet të jetë një bazë e fortë dhe i pandryshuar, ndërkaq buxheti aktual përfaqëson realitetin e të hyrave dhe shpenzimet aktuale deri me tani. Buxheti i miratuar ka qenë 12 milion e 988 mijë e 933 euro, ndërsa buxheti aktual është 13 milion e 330 mijë euro. Buxheti krijohet nga GQ dhe një pjesë nga të HVK. Me miratimin e buxhetit, komuna ka planifikuar 924 mijë euro, janë inkasuar 569 mijë euro. Kjo shumë duhet të kalkulohet në buxhetin aktual e jo në planifikim të buxhetit. Planifikimi ka qenë 924 ndërsa buxheti aktual nuk është 924. E kam thënë edhe në KPF nga të HVK janë 969 mijë euro, megjithatë ka pasur rritje të buxhetit nga buxheti fillestar dhe nga të hyrat vetanake të këtij viti i keni shpenzuar vetëm 170 mijë euro. Nga bartja e dytë e mjeteve nga vitet paraprake, 1 milion e 98 mijë euro, i keni shpenzuar vetëm 238 mijë euro, edhe pse kjo shumë e mjeteve është dashur të shpenzohet në vitin e kaluar, ju nuk e keni arritur me shpenzuar as në këtë vit dhe mendësia e juaj është me i bartur në vitin vijues. Të tabela e planifikimit, ndarja e buxhetit sipas drejtorive, dhe shpenzimet sipas programeve buxhetore e cila në këtë raport paraqitet për janar –qershor e jo për janar-shtator. Kjo është mungesë e transparencës dhe llogaridhënies. Shpenzimet të MSH në këtë periudhë janë shpenzuar mbi 822 mijë euro. Vlëra me e madhe ka shkuar për mirëmbajtje të rrugëve rurale dhe lokale, 230 mijë euro. Për asfaltimin e rrugëve janë shpenzuar vetëm 200 mijë euro. Kjo i bien që me tepër po kushton mirëmbajtja e rrugëve sesa asfaltimi. Keni kontraktuar konsulentë në shumë mbi 16 mijë euro, ndërkaq nga gjykata keni marrë gjoba mbi 27 mijë euro. Vetëm në administratën e përgjithshme dhe zyrën e kryetarit, keni paguar këshilltarë mbi 13 mijë euro, për kundër kësaj, keni paguar gjobë mbi 8 mijë e 500 euro. Shtrohet pyetja, i kontrakti konsulencën dhe prapë paguani gjobë. Mendoj se ka mungesë të transparencës edhe të MSH, kur thuhet se shërbimet kontraktuese tjera janë paguar mbi 44 mijë euro, nuk sqarohet. Nuk sqarohet se çka janë shpenzimet kontraktuese. Shpenzimet kapitale, është shqetësuese që mjetet nuk janë shpenzuar sipas dinamikës së

shpenzimit. Si ekzekutiv nuk keni arritur me i shpenzuar as përafërsisht mjetet e parapara në këtë kategori. Të SHK i kemi 4 milion e 296 mijë dhe janë shpenzuar mbi 1 milion e 400 mijë, apo 34.64%. Nuk e di si keni me arritur me i shpenzuar 65% të këtyre mjeteve apo 2 milion e 800 mijë euro, ndoshta mundeni me i realizuar, por duke pa trendin e shpenzimeve, të bënë me kuptua se nuk kanë me pasur mundësi me u shpenzuar. Të kjo kategori kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve, që taksat e tyre të shndërrohen në investime, investimet në infrastrukturë. Keni mungesë të transparencës, besoj se mjetet janë, por nuk po i shfrytëzoni. Në këtë kategori ka raste që keni kode buxhetore të ndara, në anën tjetër keni hapur procedura të prokurimit, që janë përfunduar dhe nënshkruar kontrata, por mjetet nuk i keni. P.sh. rrugën Runjevë-Stagovë, ka kaluar të gjitha procedurat e prokurimit, ndërkaq mjetet nuk i keni. Në kod buxhetor asnjë mjet nuk e keni të zotuar me këtë raport. Nuk e di ku po doni me i marrë mjetet. Është mirë me sqaruar ku i keni mjetet që po pretendoni me shtruar rrugën: Runjevë-Stagovë. I keni apo jo mjetet e zotuara? Kjo pyetje donë përgjigje. Keni planifikuar edhe mjete për projektin: Kulla për vizitor Bashkimi i dy lumenjve. Të ky projekt, kryetar e keni nënshkruar kontratën, mirëpo nuk e keni cekur në këtë raport as si planifikim, as si dështim, as si realizim. Nëse nënshkruhet kontrata dhe nuk e keni në planifikim, zotim, sikurse të parkingu nëntokësor që keni planifikuar, është shpenzuar një shumë e mjeteve, projekti ka dështuar. A ka dështuar edhe ky projekt apo jo? Të kulla vrojtuese që është paraparë një pompë vrojtuese, pika me e ulët e komunës së Kaçanikut të bashkimi i dy lumenjve, aty keni paraparë kullë vrojtuese. Të rregullimi i sheshit e potencova edhe me herët, meqenëse nuk do të ndalëm këtu. Përkushtimi në bujqësi, sa i përket infrastrukturës bujqësore, nuk keni investuar asgjë-0 investim. Subvencionet tjera dihet sesi kanë shkuar, kanë përfituar të ekzekutivit, ndërkaq në bujqësi, është 0 -investim për periudhën 9 mujore.

**znj. Ardita Rrahmani:** Raporti është diskutuar edhe në KPF, shqetësuese për mua është shpenzimi i buxhetit, duke pa se janë edhe 3 muaj në pyetje, uroj me u realizuar buxheti në këto tre muaj. Po e ndaj shqetësimin tim prapë këtu drejtor, të HVK ka të bëjë me TP, është diferencë mjaft e madhe ndërmjet planifikimit 391 mijë euro, realizimi 150 mijë euro, apo 38.54%. Diskrepancë mjaft e madhe është të taksat për leje ndërtimi, planifikimi 190 mijë euro, realizimi vetëm 13% afër 27 mijë euro. Për mua kjo është shqetësuese, se po planifikohet e nuk po realizohet.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Kërkoj sqarim për të hyrat direkte, ku janë inkasuar me pak mjete në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjithashtu të tatimi në pronë dhe të taksa komunale për leje ndërtimi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe në KPF janë sqaruar këto, drejtori ku të merr fjalën i sqaron.

**z. Agim Çaka:** Të çështja kur opozita nuk e voton buxhetin, kjo nuk do të thotë se opozita nuk ka të drejtë me diskutua për projekte apo për keq-menaxhimin e projekteve, apo rreth shpenzimeve të buxhetit. Të mjetet e bartura, drejtori nëse mundet me na sqaruar, janë diku 1 milion e 98 mijë e 860 euro, që po me duket është një shumë bukur e madhe e mjeteve që bartët nga viti në vit. Kjo tregon se nuk janë shpenzuar mjetet. Pyetja është: Pse nuk janë shpenzuar këto mjete, kur dihen nevojat e komunës? Kjo komunë është ndër komunat me të varfër në Kosovë mos të themi në nivel të Kosovës, ndërkaq në anën tjetër bartën mjete buxhetore. Besoj se drejtori na jep sqarime. Të inkasimi i mjeteve, shprehur në përqindje është 61.64%. nëse shkohet me këtë ritëm të inkasimit, i bien që deri në fund të vitit me u inkasuar 75% e mjeteve buxhetore nga të HVK. Të çështja e radhës se kush e merr fjalën, nuk është me rëndësi s kush fol dhe sa fol, është me rëndësi se çka fol. Nuk mendoj se duhet me qenë tema e debatit në këtë nivel.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Në KPF e pyetëm drejtorin për kodet që janë me nga 5 mijë euro. Sa është vlera komplet e atyre kodeve, pse me i mbajtur mjetet e shpërndara në kode buxhetore, se me ato mjete mundet me u realizuar ndonjë projekt, se nëse ministria investon në ndonjë projekt, hap kod të ri buxhetor. Të arsimi i mesëm, të shpenzimet kapitale, keni planifikuar një shumë 2988 euro për vendosjen e ashensorit të gjimnazi “Skënderbeu” në Kaçanik, kur dihet se ashensori është i vendosur. Pse i keni planifikuar këtë shumë të mjeteve?

**z. Bahri Selimi:** Do të jam i shkurtër në përgjigje, do të mundohemi me shikuar pyetjet dhe me ua kthyer përgjigjet me shkrim. Ma kryesorët do të mundohem t’i jap tani. Pati shumë pyetje për të HVK, realizimi është 61%, por është i mirë, marrë parasysh se në periudhën e fundit inkasohen me shumë mjete, sidomos të TP, se shumica e lënë kah fundi pagesën. Të mjetet e bartura, 1 milion e 98 mijë, shpenzimi është i ulët, gjithnjë i kemi dhënë prioritet shpenzimit të GQ, por shpenzimit me të ulët të fondit 22, sivjet i kanë paraprirë pengesat nga qeveria. Të hyrat janë bartur në dy pjesë, shumica e të hyrave janë bartur në mënyrë automatike nga ministria, kjo është hera e parë e bartjes, se gjithnjë u bartën me vendime të KK, në kode buxhetore për vitin vijues. Këtë vit janë bartur mjetet nga projektet e përfunduara në vitin 2023. Kadrija pyeti pse 2800 euro të projekti i ashensorit, edhe këto mjete janë të bartura, se shumica e kontratave lidhën nën planifikimin e buxhetit. Ju jeni të njoftuar për transferin e mjeteve, për mjetet të cilat na i kanë proceduar ministria për projekte të përfunduara, të cilat nuk na duhen për sivjet, ne është dashur me iu dërguar juve propozim vendimi për me i transferuar ato mjete dhe me i rialokuar në kodet tjera buxhetore. Të MSH është një kod buxhetor që përfshinë shumë shpenzime, shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale, janë shpenzimet për komitetin e auditimit, komisione të ndryshme. Shumica e mjeteve apo 90% e tyre janë për kompensimin e administratorëve të fshatrave. Këta nuk kanë kryer ndonjë këshillë juridike që me ndikuar të ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Unë e kam sqaruar edhe me tekst se çka përfshinë ky kod buxhetor, nuk bëhet fjalë për shpenzimin e ndonjë avokati apo të ngjashme, se komuna i ka zyrtarët për këto çështje. Pasi të përfundoj, e kisha lutur DSHPE, për sqarime, se janë mjetet, është GP ku përfshihen në këtë projekt, MAPL, DEMOS, komunë, janë mjetet, se ne nuk mundemi me realizuar projekt pa pasur mjete.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Kam një nën pyetje për drejtorin, të çështja që e potencoj se janë bartur mjetet 2800 euro për ashensorin. Ato mjete ekzistojnë, atëherë a keni të drejtë me bërë një aneks kontratë me rregulluar ashensorin prej kur ka rënë murmurima, nuk e dimë kur ka gjuajtur, por drejtori ka thënë. A mundem ato mjete me i futur në funksion? A mundeni me u përgjigjur në këtë pyetje?

**z. Bahri Selimi:** Përgjigjen Kadrije do të jap me shkrim.

**z. Zahir Doda:** Pas mbledhjes, nëse keni dëshirë tre veta shkojmë të gjimnazi dhe e shikojmë pllakën ku e ka gjuajtur murmurima dhe të mbyllim këtë çështje. Dje ka ardhur operatori e ka marrë me vete dhe pritet me u rregullua. Keni thënë se ka kushtuar 50 mijë euro, tani po del se ka kushtuar 27 mijë euro.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Drejtor, nëse nuk të duket shqetësim çështja e ashensorit që e ngritëm, dhe për rastin në fjalë, paska pasur me mbetur ashensori ashtu. Ne jemi këtu me i ngritur çështjet, ju jeni me i udhëhequr punët se bashku me drejtorin e shkollës.

**z. Naim Beça:** Nuk e kuptova drejtorin kur e potencoj se qeveria ka paraqitur pengesë të çështja e alokimit, bartjes së mjeteve, a ka ndodhë me herët kjo, jo asnjëherë. Nëse mjetet janë bartur nga viti 2019, kjo qeveri nuk ka qenë nga viti 2019. D.m.th. qeveria është kundër ndërtimit të një ashensori, me i bartur mjetet në një projekt të veçantë, jo qeveria nuk është kundër.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Naim e keni gabuar pyetjen.

**z. Bahri Selimi:** Naim, nëse është pyetja e jote për bartjen e mjeteve, unë e theksova me herët, bartja e mjeteve nga vitet paraprake në vitin vijues, janë mbi 1 milion euro. Është hera e parë që janë bartur në këtë mënyrë, ndërsaq nuk ka ndodhur me herët kjo. Shuma 230 mijë euro janë bartur me vendim të KK, ndërsaq tjerat 867 mijë euro, janë bartur me automatizëm nga MF, e kemi theksuar këtë çështje në raportin 6 mujor.

**z. Agim Mani:** Shuma 867 mijë euro janë bartur me vendim të KK. E keni sjellë në KK si pikë e rendit të punës.

**z. Bahri Selimi:** Jo Agim, nuk është e vërtetë, shuma 867 mijë euro që janë bartur nga MF me automatizëm.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ato çështje Agim i sqaroni me drejtorin.

**znj. Arlinda Raka-Rakoci:** Të të hyrat direkte, drejtor nuk me jepe sqarimin. Unë e pash se ka ndryshime në tatim, por prapë se prapë shuma është mjaft e lartë 164 mijë euro. Kërkoj një sqarim për këtë, se si duket nuk iu duket pyetje shumë e rëndësishme. Në KPF e ndoshta e keni dhënë sqarimin, por unë nuk jam pjesë e KPF.

**z. Bahri Selimi:** Edhe këtë përgjigjen Arlinda do të ua kthej me shkrim, se pati shumë pyetje, për të cilat përgjigjen kam me kthyer me shkrim. Me shkrim do të kthej përgjigjen edhe për lejet ndërtimore.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nëse ka mundësi t'na i sjellin përgjigjen me shkrim edhe për taksat tjera administrative, në KPF u sqarua, por për ata të cilët nuk e dinë, se në planifikim janë 1 mijë euro, realizim mbi 65 mijë euro. Arsyetimin që na vjen, lë të jetë informatë për të gjithë anëtarët e KK.

**z. Bashkim Luma:** U përmend mirëmbajtja e rrugëve lokale, shuma 140 mijë euro, ndërsa kur vijmë nga Strazha për në qytet, në atë pjesë shihet se ka shumë pengesa të rrugës. Ato pengesa janë ka vite, ndërkaq nuk është marrë asnjë veprim në këtë drejtim. U përmend mirëmbajtja e ndriçimit publik, shuma 16 mijë e 700 euro përafërsisht, mjetet po shpenzohen, ndërkaq ndriçimi publik ka ende probleme në shumicën e vendeve në komunë. Hiq me lartë se sot në ora 10:00, duke ardhur nga shtëpia, rruga "Idriz Seferi" kishte pasur ndriçim publik ditën, kjo është e tmerrshme. Të mirëmbajtja rutinore, nga DUKMM është lidhur një kontratë 22 mijë euro për deponimet ilegale. Nëse mundet drejtori me na sqaruar se çka do të thotë kjo kontratë, cilat janë obligimet që do të kryhen përmes kësaj kontrate?

**z. Ramadush Osmani:** Po ndërlihdëm të pyetjet, Agimi e ka marrë përgjigjen në KPF, sigurisht për shkak të opinionin publik donë me përsëritë prapë, po e përsërisë. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës është në mesin e projekteve me grantin e performancës. Ligji i GP e mundëson MAPL edhe projektet që nuk i kemi të koduara me buxhet, mundet t'i parasheh se hapet pastaj kodi në ministri. Ky projekt i ka mjetet e zotuar, 205 mijë janë nga MAPL, si pjesë e GP, pjesa tjetër është më bashkëfinancim nga kodi i bashkëfinancim nga drejtoria. Mjetet janë të zotuar, operatori është përzgjedhë, ka ankesë nga OSHP, nëse na kthehet përgjigja brenda kohës, besoj se i realizojmë këto mjete. Të Ndriçimi publik të rruga "Idriz Seferi", asambleisti tha se është e tmerrshme ndriçimi publik ditën. Duhet ditur se ai projekt është duke u punuar, është duke u testuar. Operatori është aty, dje është lëshuar dhe është duke u testuar, nuk është çështje që ka ngelë pa u intervenuar me kohë. Ju e dini se të mirëmbajtja e ndriçimit publik ka pasur një kohë të gjatë që kemi pasur ankesa, tani e kemi kontraktuar kompaninë dhe jemi duke vazhduar në secilin rrjet, janë diku 85 rrjete të ndriçimit publik, të cilat i kanë 3mijë llampa ndriçuese, në vazhdimësi mund të ketë defekte dhe do t'i mirëmbajmë. Për mirëmbajtje, kontrata është aktive, përfshinë mirëmbajtjen verore dhe dimërore. Mirëmbajtja dimërore është pjesa e borës dhe kripës, verore largimin e gurëve rrëshqitjeve të dheut dhe gropave në asfalt. Shumë shpejt do të intervenojmë edhe në rrugën: Gajre-Ivajë.

**z. Agim Mani:** Megjithëse është raport financiar, përfshinë një periudhë 9 mujore, mos me sqaruar në detaje, kjo ngelë e mangët. Raportin nuk e sjellin të kompletuar në KK, nëse nuk doni me dhënë sqarime, kjo i bien se nuk doni me qenë transparente. Pyetjen të cilën e bëra: Rruga: Runjevë-Stagovë nuk ka kod buxhetor, a ka kod buxhetor? Janë 230 mijë euro të lira nga GP.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E shpjegoj drejtori, drejtori e theksoj që projektet që financohen nga GP munden të jenë edhe pa kod buxhetor.

**z. Ramadush Osmani:** Mos e dezinformo opinionin, shuma 230 mijë euro janë mjete të cilat DEMOS i ka alokuar në buxhetin tonë për tre projekte: 1. Izolimi i shkollës “Nazmi Osmani” 2. Parqet Publike, 3. Trotuari të Fusha e pajtimit. Mjetet janë shpenzuar se janë lidhur kontrata, nuk janë as 50 mijë euro të pashpenzuara.

**z. Agim Mani:** Nga GP janë në total 286 mijë euro. Në KPF arsyetimi ka qenë tjetër. Projekti i rrugës: Runjevë-Stagovë është kod tjetër, është buxhet tjetër. GP në total i cekur në raport është 286 mijë euro, janë shpenzuar 55 mijë euro, kanë ngelur të lira 230 mijë euro, ndërkaq ju po thoni se nuk janë këto mjete. Ku janë atëherë këto mjete? Edhe pyetjen tjetër të cilën e bëra, nuk mora përgjigje për projektin e ndërtimit, Kulla për vizitor bashkimi i dy lumenjve, projekti ka filluar, mjetet i keni shpenzuar, ndërkaq nuk i keni cekur në raport se, a ka dështuar ky projekt, sa mjete kanë qenë të planifikuara dhe sa janë realizuar?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Qeveria e juaj e ka ndal projektin e trotuarit të rrugës Doganaj, edhe pse është obligim dhe kërkesë disa viteve, ku ka pasur edhe humbje të jetëve aty.

**z. Agim Mani:** A keni konkurruar me projekt, a e keni nënshkruar kontratën të projekti i ndërtimit të kullës?

**z. Ramadush Osmani:** GP është i përbërë nga dy fonde, DEMOS, me 51% të mjeteve i procedon në buxhetin e komunës, 49% MAPL i menaxhon. Mjetet e MAPL nuk i sheh në buxhet, se situacionin ata vijnë e kontrollojnë dhe e paguajnë, 205mijë euro. Nëse e lidhim kontratën për rrugën: Runjevë-Stagovë, 205mijë euro situacioni shkon dhe paguhet në MAPL dhe ato mjete nuk i shohim ne. Edhe shuma 60 mijë euro për parkun e qytetit që është bashkëfinancim nga MAPL, nuk i shohim, ndërkaq i shohim vetëm mjetet për tre projektet që mjetet i procedon DEMOS. Të çështja e kullës, është projekt të drejtoresha. Projekti është fituar nga MRZH, është hap tenderi, se ka ardhur zotimi prej MZHR për ato mjete, ka bërë kërkesë për pëlqim mujor të ministria, nuk i ka ardhur me kohë, është duke u pritur me u nënshkruar, nuk e nënshkruan ministri, operatori ka filluar dhe inspektorët e kësaj ministrie ja kanë ndërprerë se nuk ia japin pëlqimin, pa ndonjë arsye. Nëse 1 muaj, nuk ia kthen përgjigjen, heshtja është aprovim. Për trotuarin Fusha e pajtimit, unë e kam bërë kërkesën me kohë, departamentit të rrugëve në ministrinë e Infrastrukturës, për pëlqim, nuk më ka kthyer përgjigjen pas një muaji. I kam shkruar zyrtarisht, jam në procedura të prokurimit, mundësisht trajtoni me kohë çështjen e pëlqimit për trotuarin. Nuk ka kthyer përgjigje. Pas një muaji i kam shkruar përsëri se janë kryer procedurat e prokurimit, mundësisht na dërgoni pëlqimin. Nuk ka kthyer përgjigjur, kështu kanë filluar punimet. Kur kanë ardhur inspektorët, i kam njoftuar me dokumentet, se nuk është dhënë pëlqimi, përkundër kërkesave, nuk është dhënë pëlqimi, atëherë e kemi bërë projektin me mjetet tona.

**z. Selajdin Troni:** Kam një ankesë, nuk është e drejtë veç se e ke mundësinë me marrë fjalën dhe me bërë zhurmë këtu e mos me të kuptuar asgjë. Për inatet e tua që e ke Agim, nuk mundemi ne me të dëgjuar me fol 1 orë këtu.

**z. Agim Mani:** Përgjigjet nuk po epën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos ndërhyjë Agim në diskutim.

**Ernesta Krasniqi:** Me qetë kryesues kur të folësh.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk mundesh me më mësuar, ti mundësh me u ulur e me më dëgjuar.

**z. Selajdin Troni:** Çdo herë kur të foli unë, Ernesta ndërhyr në diskutim Mundesh me hyrë me i pa incizimet, çdo herë kur të foli në, ndërhyr në debat. Prit të kryej njëherë unë diskutimin, pastaj diskutoni ju.

**Ernesta Krasniqi:** Kërkoj falje Selajdin.

**z. Bashkim Luma:** A bënë me ditur ku testohet ndriçimi publik, se unë nuk pash se është duke u testuar.

**z. Ramadush Osmani:** Me gjithë respektin Bashkim, se kur diskuton shumë pak dhe je më i arsyeshëm, në këtë rast nuk je i arsyeshëm. Dje është lëshuar ndriçimi publik, është vendosur edhe censori dhe është duke u testuar. Kërkesën e komunitetit e kam pardje, me lëshuar ndriçimin publik. Kam shkuar edhe vet i kam pa, projekti është në ekzekutim.

**z. Rustem Zenuni:** Jam shumë i shqetësuar, pse kanë njerëzit dëshirë me dështuar projektet? Ne jemi këtu me i përfaqësuar qytetarët dhe me bërë përpjekje maksimale me zgjidhur problemet. Shumë mirë që bëhet kulla atje mbi lumenj, pastaj trotuari, por pse është ky presion, angazhim kaq i madh me dështuar projektet, me u ndërprerë punimet. Definitivisht mundemi me pyetur, a janë normal këta njerëz?

**z. Agim Mani:** Pasi na ka ofenduar, me duhet me marrë fjalën, se na pyeti a jemi normal apo jo. Nëse donë me kuptuar realitetin, duhet me lexuar, por ti nuk po e kupton realitetin. Unë isha shumë i qartë, e theksova se kontrata është nënshkruar pa marrë pëlqim, a është realitet kjo, se nuk mundeni me realizuar kontratën pa pasur pëlqim, ju keni me realizuar kontratën, jo ne, nëse bëni shkelje, nuk keni me mundur me realizuar kantatën.

**z. Rustem Zenuni:** Duhet me pranuar se heshtja është pranim, unë nuk kam faj pse nuk e dinë, por mos të flasin kur nuk e dinë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi duke e realizuar Agim. Përfundoj debati për këtë pikë Rustem. E ndërpres diskutimin për këtë pikë, Raporti ishte sa për njoftim. Atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,

#### NJOFTOHET

**Me Raportin nëntëmuor financiar, për periudhën: Janar-Shtator 2024/ Lënda: 01Nr. 400/03-26652/24.**

### 3.Raporti i Përformancës komunale për vitin 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Po jap një elaborim të shkurtër, pasi na prekë me shumë neve në KK. Vlerësimin e përformancës e bënë MAPL në çdo fund të vitit, ku trajtohet 16 fusha e 82 tregues, ku për disa tregues nuk ka mundur me marrë fillimisht vlerësime reale, pastaj MAPL i ka ngrirë. Edhe në KPF kur është diskutuar, e kam potencuar se ka edhe vlerësime jo reale në fusha të caktuara. Sa i përket transparencës, ne jemi vlerësuar 100%, e që për mua nuk është ky vlerësim real, se askush nuk mundet me qenë transparent 100%, as një institucion, ndërkaq nuk jemi vlerësuar në disa tregues padrejtësisht. Po i ceku disa që kanë të bëjnë me KK: Mos diskutimi i raportit të auditorit në KK. Ju krejt e dini se raporti i auditorit është diskutuar në KK, se ku është problemi nuk e di. Unë e kam pyetur zyrtarin, me ka thënë se informatën e kam dërguar në ministri, me ka treguar edhe për vërejtjen që e ka bërë në këtë fushë, e që ata nuk e kanë marrë parasysh. Pastaj, prezenca e kryetarit të komunës në mbledhje. Ne e dimë që kryetari i komunës merr pjesë në mbledhje të KK. Ka edhe fusha tjera që ka mospërputhje në mes realitetin dhe vlerësimit. Në kuadër të këtij raporti, është organizuar edhe debati me Jeta Xharra, ajo i kishte marrë disa fusha, të punësimi ne jemi kah fundit me vlerësim të punësimi i komuniteteve. Ne

nuk kemi komunitete dhe nuk mund të zbatojmë këtë fushë, ndërsa në fusha tjera qëndrojmë në mesatare apo mbi mesataren. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky është raport që na ka ardhur nga MAPL, me herët ishte se raporti ka ardhur nga ekzekutivi, por kryesuesi nuk u pajtua me raportin që ka sjellë dikush tjetër, dhe ne kemi të drejtë mos me u pajtuar me raportin që e keni sjellë në KK. Ky raport ka disa mangësi, është e rëndësishme të trajtohet ky raport me seriozitetin me të duhur, duke i identifikuar fushat që ka nevojë me i përmirësuar. Për të marrë vendime efektive dhe për të avancuar zhvillimin e komunës, është e nevojshme që raportet e tilla të jenë të plota dhe të detajuara. U potencua se transparenca është 100%, kështu duhet të trajtojmë se kështu është në raport, por kur thuhet se transparenca është 100%, ndërkaq aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun janë 0, unë nuk e di ku është transparenca këtu? Publikimi i raporteve për proceset e diskutimeve publike janë 0. Diskutimi i auditorit të jashtëm dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të auditorit janë 0. Kjo i bien që KK nuk ka plan të veprimit për me i zbatuar raportet e auditimit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raporti i auditorit dhe plani i veprimit ekzistojnë.

**z. Agim Mani:** Kryesues ju nuk ishit këtu me herët, ndërkaq unë e potencova se raportet që vijnë nga një institucion tjetër, nuk po i përkrahni. Edhe ne kemi të drejtë që raportin që na ka ardhur mos me përkrahur. Ky është një raport dhe raporte të tilla po sjelli në KK, transparenca është 100%, ndërkaq plani i veprimit është me vlerësim 0. Niveli i pagesës të procesuara në afate ligjore, është 0. Mbrojtja e mjedisit është 0. Mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale është 0, ndërkaq janë shpenzuar shumë mjete.

**z. Rustem Zenuni:** A është e vërtetë se mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale është 0?

**z. Agim Mani:** Nuk po e themi unë, po e thotë raporti. Ju mundeni me u ankuar në raport, jo të unë. Kur u përmend se transparenca është 100%, pse nuk reagoje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rustem, mos ndërhyjë.

**z. Agim Mani:** Të zhvillimi ekonomik, nuk ka strategji për zhvillim ekonomik, vlerësimi është 0, kjo është e vërtetë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është një vlerësim i raportit nga dikush tjetër, jo nga ne. Po të ishte vlerësimi yni, do të thoni se e keni rregulluar pakëz, por është vlerësim i MAPL. Nëse bazohemi në raport, ne si komunë qëndrojmë mirë, ka shumë tregues që janë me 85%, por ka edhe me 100%. Në raport thuhet se a është diskutuar në KK raporti i auditorit dhe plani i veprimit. Vlerësimi jepet se nuk është diskutuar, ndërkaq ne krejt jemi dëshmitarë se janë diskutuar, ndërkaq a është i mirë apo i keq, ajo është diçka tjetër. Unë vet Agim e potencova se nuk jemi 100% transparent, jemi shumë me shumë se të tjerët, por jo 100%, kështu që këtë vlerësim të jashtëm, ne e marrim si të tillë. Është raport, duket të vlerësojmë, e kemi pasur afatin për me i dhënë vërejtjet tona, diku janë marrë parasysh vërejtjet diku jo, është raport përfundimtar, që përkufizon punën tonë 1 vjeçare të komunës.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Qysh e tha edhe kryesuesi paraprakisht, ky raport i performancës është raportuar prej zyrtarëve komunal prej krejt drejtorive. Grupi punues ka një koordinator. Raporti i performancës ka ne veti fusha të përcaktuara, fushat kanë tregues, e treguesit kanë nën tregues, mbi bazën e të cilave kanë dalë pikët. Dokumentin të cilin ju e keni, përfshinë performancën e komunës në vitin 2023 -pjesa e parë, ndërsa pjesa e dytë është pjesa e raportit të bashkangjitur, i cili i paraqet fushat. Përkundër analizës dhe dokumenteve që i kanë dërguar dhe vendosur në sistemin e menaxhimit të performancës komunal, ministria nuk ka reaguar

dhe nuk i ka marrë për bazë komentet. Një prej asaj është përgjegjshmëria komunale, ku në tregues Agimi i ceku publikimin e raporteve të proceseve të konsultimeve publike. E kemi komentin e ministrisë, ndërkaq bashkangjitur komenti për raportimin nga zyrtarët komunal, ku mund t'i gjeni dokumentet për dëgjime buxhetore. Pika tjetër ishte treguese për raportin e auditorit të jashtëm dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditorit, ne jemi dëshmitarë të asaj se këto dokumente sjellën në KK për diskutim, raporti i auditorit, dhe plani i veprimit se si me i larguar ato gjetje të dhëna në raportin e auditorit, cilat janë ato veprime e drejtorive me i larguar ato gjetje. Kur është diskutuar raporti i auditorit edhe ju keni qenë prezentë. Edhe treguesit tjerë që janë potencuar në këtë raport, janë edhe dokumentet që janë bashkangjitur, por fatkeqësisht nuk kemi pasur përgjigje, edhe pse koordinatori me grupin punues kanë paraqitur një ankesë në MAPL brenda afatit ligjor, por është refuzuar. Tani nuk kemi zgjidhje tjetër, vetëm me u adresuar në gjykatë me padi.

**znj. Ardita Rrahmani:** Raporti është diskutuar edhe në KPF, është e vërtetë se disa pika shihet se nuk janë korrekte, ndërkaq kemi me i vuajtur pasojat të gjitha ne si subjekte politike ne si LDK, pastaj PDK, LVV, AAK, NISMA, se nuk është praktikë kjo e mirë, kjo kushdo që e harton raportin se nuk po dua as me ditur kush e ka hartuar, këtu figurojnë disa vlerësime me 0 pikë. Ajo që duhet ekzekutivi në këtë rast, nëse është faji të ministria, atëherë me bërë një presion, me na trajtuar ashtu siç është realiteti. Edhe aty ku jemi me mirë, vlerësimi me qenë korrekt, se me shikuar raportin, po dalin shumë 0, e që në realitet nuk janë, pastaj po dalin edhe shumë vlerësime maksimale, e që nuk janë në realitet. Kisha kërkuar nga ekzekutivi që përmes zyrtarit kompetent, që nuk po dua me ditur as kush është, me bërë një presion në ministri, që poentomi me qenë me real. Ndoshta këto komunat e vogla nuk po i shikojnë shumë, e po japin një vlerësim vetëm formalisht. Po me vjen keq, unë jam qytetare e këtij vendi, paguaj taksa këtij vendi, si ai në Prishtinë apo në Pejë, kështu ju lutem që ushtroni presion në MAPL për vlerësim të drejtë në performancën komunale.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe pse kjo është një informatë, është punë e kryer, pasi është Fatluma-koordinatori e GP, ju kisha lutur të merr fjalën:

**znj. Fatlume Guri-Selimi:** Po mundohem shkurt me dhënë disa sqarime.

**z. Naim Beça:** Me fal nëse mundesh me treguar se kush jeni, se nuk të kam të paskemi parë kurrë në jetë. Mos e merr për të keq, se nuk të paskemi parë kurrë. Çfarë roli keni këtu?

**znj. Fatlume Guri-Selimi:** Jam nga Zyra për Informim. Desha me u ndërlidhë të konsultimet publike, është i publikuar raporti i vitit 2023, janë diskutime buxhetore, kam bashkëpunuar me ekspertin e DEMOS, nuk e di pse është vlerësuar me 0 pikë. I kemi bashkëngjitur edhe komentet. Çdo vit dokumentet që janë vlerësuar me pikë maksimale, ndërkaq në këtë vit janë vlerësuar me 0 pikë. Kjo është besoj me u adresuar.

**z. Rustem Zenuni:** Ne jemi bërë standard për qeverisje lokale për transparencë, organizim, debate publike. Unë kur e kam pa këtë raport, kam një vlerësim se ka tendencë me na i minimizuar aktivitetet e arritura. Sido që të jetë, të mbetet në ndërgjegjen e tyre. Me 0 pikë është vlerësuar raporti i punës së KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Vlerësimi nuk është tendencioz, se kjo nuk është vetëm ndaj komunës tonë.

**z. Agim Çaka:** Raporti i performancës është një tregues sesi përformon komuna në të gjitha aspektet, si në planifikim të buxhetit, shpenzim të buxhetit, realizim të projekteve, transparencë dhe në gjitha aktivitetet tjera. Raporti i performancës duhet të jetë real dhe jo paragjykes dhe i njëanshëm. Ky raport nuk duhet të jetë sa për të u vet kënaqur, por duhet të jetë raport i drejtë

në mes të asaj që shkruhet dhe zhvillimit ekonomik të komunës. Nëse sot për sot vlerësoj se sa i përket zhvillimit ekonomik jemi jashtëzakonisht keq, atëherë del një raport i mirë i performancës është në kundërshtim me investimin e përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Kur të bëhen këto raporte, duhet pasur një matës në mes të asaj që është realizuar dhe asaj se çka shkruan në raport.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti i performancës ishte sa për njoftim, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës në këtë mbledhje,

## NJOFTOHET

**Me Raportin e Performancës komunale për vitin 2023/ Lënda: 01Nr. 02-060/01-26021/24.**

### 4. Informatë për përfundimin e Vitit Shkollor, 2023-2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është këtu, e hapi Diskutimin, pastaj ia kaloi fjalën drejtorit:

**z. Agim Mani:** E përgëzoj drejtorin e DA për raportin që e ka sjellë në KK. Në raport është pasqyruar në formë të saktë aktiviteti i arsimit. Është e nevojshme t'i shprehi disa shqetësime që dalin në pah në bazë të këtyre statistikave. Shqetësuese është rënia e numrit të nxënësve nga viti në vit. Në bazë të statistikave, nga viti 2017 deri me tani, numri i nxënësve ka rënë për 1350 nxënës. Kjo gjendje të bënë me kuptua për me marrë veprime të shpejta dhe efektive, për me aplikuar politika stimuluese dhe motivuese që nxënësit t'i mbajmë në shkolla. Tjetër shqetësim, parregullsitë në konkurset të cilët shpesh herë anulohen për interesa të ngushta. Ka pasur raste kur është hapur konkurs për të çerdhja e fëmijëve, janë kryer të gjitha procedurat rekrutuese 2 herë me shkrim dhe me gojë, pastaj anulohet konkursi. Shqetësuese, për derisa nuk e merrni njeriun që ju doni me marrë, nëse i kalon të gjitha testet dhe nuk pranohet, kjo të bënë me kuptuar se diçka nuk është në rregull. Të Shkolla fillore "Agim Bajrami" "unë i kam fëmijët në atë shkollë, e shoh se vinë herët, mungon arsimtari i historisë dhe arsimtari i muzikës. Viti shkollor ka filluar që 2 muaj, nuk ka arsimtar të historisë, kush do të merr përgjegjësinë me i notuar ata nxënës. Janë në përgjegjësi të juaj drejtor këto çështje. Shqetësim tjetër, mbyllja e bibliotekës së shkollës në Stagovë, që 4 vite, punëtori ka dal në pension. Unë jam në këshillin e prindërve në fshat, kemi kërkuar që bibliotekën me marrë në mbikëqyrje shkolla. Është bërë kërkesa, ju nuk e keni lejuar, nuk keni hapur konkurs, për me funksionalizuar bibliotekën në Stagovë, e cila që 4 vite është e mbyllur. Po ju drejtohem juve drejtor se jeni drejtor i arsimit, keni punuar shumë vite në arsim, në arsim me së paku duhet me bërë politikë. Është mirë drejtor, me u fokusuar në këto çështje, e me pak me u fokusuar ku organizohen debate të PDK.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Në bazë të tabelarëve të paraqitur në raport, shihet se ka numër të madh të mungesave të nxënësve, e që shumica e tyre ishin të arsyeshme, kjo është shqetësuese. Pastaj kalueshmëria e testit të arritshmërisë së semimaturantëve, të cilët e kishin kaluar vetëm 43.66% në nivel të komunës, kjo është shqetësuese.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Edhe në këtë vit shprehi shqetësimet e mija për transportin publik të nxënësve të f. Kovaçec dhe Llanishtë. Nga të dy këto fshatra, vazhdimisht marr ankesa nga prindërit, sesi është e mundur, në vend se t'iu paguhet transporti, komuna e Kaçanikut e ndalon një gjë të tillë. Duke u nisur nga fshati Llanishtë, transporti ka qenë në orar të rregullt në 7:30 në mëngjes, në ora 12:00 i ka kthyer nxënësit e paradites, pastaj i ka marrë nxënësit e pasdites dhe në ora 5 i ka kthyer nxënësit e pasdites. Tani ekziston në Llanishtë vetëm një orar, orari në mesditë, ndërkaq ka nxënës të klasës parë të cilët detyrohen me organizuar fshati që dikush

prej prindërve mos me shkuar në punë, me organizuar transport për nxënës. Kjo është shumë shqetësuese. E keni cekur drejtor se në bazë të kilometrave nuk i plotësojnë kriteret, kur kam pyetur për f. Kovaçec, e kuptojmë këtë çështje, por tani që është ndërruar ora, bëhet vonë me u kthyer, çështja e qeneve endacak, kjo paraqet shqetësim të te gjithë prindërit e f. Kovaçec dhe Llanishtë. Pyetje, nxënësit që vijnë mësimin në Llanishtë dhe shkolla fillore “Emin Duraku”, nuk e kanë të hequr të gjitha shpenzimet e udhëtimit, ata paguajnë 50%, prindi, 50% komuna. Komuna e ka obligim që me rregulluar çështjen e transportit të nxënësve. Nëse është rregullorja që përcakton se mbi 4 km. nxënësve iu sigurohet transporti, atëherë e sjellin atë rregullore të ndryshojmë, se vetëm këto 2 fshatra janë duke hequr për transport të nxënësve. Ne duhet me iu ofruar kushte, se atëherë detyrohen me lëshuar fshatin, si f. Llanishtë për me pasur shkollën me afër.

**z. Selajdin Troni:** Me Kadrijen e kemi biseduar problemin e transportit të nxënësve në f. Kovaçec. Çështja është se 2 herë i kanë bartur nxënësit, por shkak i çmimit që nuk ka pasur llogari, i kanë ndërprerë. Nuk besoj se ka ndonjë problem tjetër. Është e vërtetë se ka qarkullim të madh të automjeteve në atë rrugë, por një plus i madh është që shkolla punon vetëm me një orar, nuk ka mundësi me i nxënë terri.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Janë nxënësit e shkollave të mesme që punojnë me dy ndërrime.

**z. Zahir Doda:** Kur kam ardhur me udhëhequr drejtorinë e Arsimit, e kam gjetur një praktikë të mirë, që me sjellë informata për fillim të vitit shkollor dhe për mbarim të vitit shkollor. Informata nuk votohet. Informatën Agimi e pëlqeu, tha është reale, kjo me ka interesuar mua. Informata është për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024. Të gjitha tjerat ishin pyetje, për të cilat mundem me u përgjigjur, por tani asnjë koment.

**z. Kadri Krivenjeva:** Zëvendës kryesues i KK sipas detyrës zyrtare: Fjalën e ka Agim Mani:

**z. Agim Mani:** Informata ishte aq e saktë, sa që i kanë dalë në pah parregullsitë. Unë për parregullsitë nuk kam informata, por jam bazuar në informatë. Në informatë thotë kështu, në Stagovë nuk ka arsimtarë të historisë që 2 muaj. Ju nuk po doni me dhënë përgjigje. Pse po i ikë përgjigjes drejtor? Nuk ka arsimtarë të muzikës, nxënësit shkojnë në shkollë dhe vijë, nuk e mbajnë orën. Pyetja ime është, kush do t'i notoj ata nxënës?

**z. Zahir Doda:** Pyetjen është dashur me bërë kur kemi qenë në pozicionin pyetje dhe kërkesa.

**z. Agim Mani:** Konkursët janë të politizuara. Nëse ju nuk doni me u përgjigjur, mos u përgjigjeni, por kjo nuk është ferr, duhet të përgjigjeni para qytetarëve. Çka është në pyetje çështja e bibliotekës në Stagovë, që 4 vite është mbyllë?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Kryetar, qysh e shihni ju përgjigjen e drejtorit karshi asambleistave, kur tani për momentin qytetarët janë duke na dëgjuar. Shqetësimet qytetarët na i kanë dhënë neve me i adresuar këtu, ndërkaq drejtori thotë se unë nuk mundem me u përgjigjur, se unë ja, këtu informatën. Për momentin kur unë pyeta për ashensorin, drejtori erdhi nga atje dhe u përgjigj këtu, ndërkaq tani kur jeni këtu, përgjigjuni, se banorët e f. Llanishtë janë duke na dëgjuar direkt. Nuk ka transparencë këtu, nëse ti nuk je i gatshëm për përgjigje, nëse nuk donë me u përgjigjur direkt, se paku na e kthen përgjigjen me shkrim. Ne jemi të votuar kryetar, ankesat e qytetarëve i sjellim këtu, drejtorët janë të emëruar nga ju dhe duhet me na dhënë llogari dhe me qenë transparentë para qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përgjigje po, ndërkaq drejtorët i japin llogari Kryetarit të Komunës.

**Kryetari i Komunës:** E di se jeni të votuar prej qytetarëve. Pyetjet kur i adresoni Kadrije, ju përgjigjen, kjo ishte informatë për përfundimin e vitit shkollor. Ju nuk bëtë pyetje për përfundimin e vitit shkollor, ju bëtë pyetje për krejt tjetër temë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pyetjet ishin për në arsim.

**Kryetari i Komunës:** Informata ishte për përfundimin e vitit shkollor, është e drejtë e drejtorit mos me u përgjigjur.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Nxënësit me mbetur në rrugë, a nuk iu duket shqetësuese, ti je përgjegjës direkt për këtë çështje, për derisa e mbështet drejtorin.

**Kryetari i Komunës:** Kur të bëni pyetjen direkt, të jap përgjigje, mos i gënjeni njerëzit. Ku po e dini ju çështjen e konkursit sesi ka ndodhur? Pse po paragjykoni edhe ju edhe Agimi, a e dini rregulloren?

**z. Agim Mani:** Kush jep llogari që nuk ka arsimtar të historisë në Stagovë. Kush do e notoj.

**Kryetari i Komunës:** Unë jepi llogari. Unë i notoj. A mundeni me nënshkruar diçka që është e paligjshme. Është rregullorja e re, e kemi ngritur si shqetësim, se është problem me pranuar punëtor. E theksove se e ka dhënë testin me shkrim, 75 pikë, e ka dhënë edhe me gojë, nuk ka mundur me i arritur 70 pikë me rregulloren e re dhe është dashur me anuluar konkursin 2 herë. Mos dezinformoni opinionin, pa argument, merrni rregullohen e re e shikoni se e kemi problem me rekrutuar mësimdhënës, kështu të gjithë konkursit për mësimdhënës janë anuluar këtë herë. E kemi ngritur këtë shqetësim aty ku duhet, por nuk është marrë parasysh. Ajo është politikë e arsimit që e bënë.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Unë fola në kuadër të informatës, për numrin e madh të mungesave që janë shumë të arsyeshme, nga 95 mijë, 72 mijë janë të arsyeshme, numër ky shumë i madh. Fola edhe për kalueshmërinë e testit të arritshmërisë së semimaturantëve, të cilët e kishin kaluar vetëm 43.66% në nivel të komunës, këto janë shqetësuese, duhet me ndërmarrë diçka në këtë drejtim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe për ne janë shqetësuese.

**z. Zahir Doda:** Ajo është koment, nuk kam çka me thënë, ashtu është gjendja. Për pyetjet është dashur të ngritën në kuadër të pyetjeve dhe kërkesave. Tani për pyetjet për Llanishtë etj. e për të tjerat, kur të kemi në rend pune jap përgjigje, se tani kam të drejtë mos me u përgjigjur.

**z. Agim Çaka:** E kuptoj se ky është një raport i DA, pajtohem me atë që është përgatitur në formë shumë profesionale. Shtohet pyetja, a duhet me debatuar ne rreth raportit? Kjo është çështje tjetër. Nëse ne duhet me vlerësuar vetëm si raport a është i mirë a është korrekt, i punuar në formë profesionale, del se është krejt në rregull. Mirëpo, kjo nuk na mohon të drejtën për me diskutuar. U diskutua çështja e zvogëlimit të numrit të nxënësve, krejt e dimë ne që kjo nuk është në dorën e drejtorit të DA për me rritur numrin e nxënësve apo me i ndal nxënësit që me mësuar këtu. Realisht kjo pasqyron diçka, është një indikator që reflekton të drejtori, që tregon që në komunën tonë nuk i kemi punët bash mirë sa i përket çështjes se arsimit, nxënësit nuk shohin perspektivë dhe detyrohen me shkuar në komunat tjera, kështu zvogëlohet numri i nxënësve në komunën tonë, rritet numri i nxënësve në një komunë tjetër që i ka punët më mirë sesa komuna jonë. Në kuadër të kësaj ne po duam me diskutua. Të mungesat, të kualiteti i mësimdhënësve, nota mesatare, ka shumëçka me diskutuar këtu, por ne duhet prekur temat kyçe, si mbyllja e shkollave, rënia e numrit të nxënësve, që është shumë shqetësuese e që siç thashë me herët, po del se ne nuk jemi duke performuar mirë si komunë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës,

## NJOFTOHET

**Me Informatën për përfundimin e Vitit Shkollor, 2023-2024/Lënda: 01Nr. 04-610/01-26555/24.**

**5. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;**

Siç e dini, me dhënien e dorëheqjes nga komisioni të Rustem Zenuni, duhet të plotësohet komisioni me një anëtar nga KK, sipas rregullit. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Kryesuesi i Kuvendit konstaton me shkuar me propozime konkrete:

**z. Rustem Zenuni:** Nga PDK për anëtar të komisionit, propozojmë, Florina Lika-Vishi.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** A ka të drejtë Rustemi me propozuar, se ka qenë vet anëtar i këtij komisioni?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sigurisht se ka, Rustemi ka dhënë dorëheqje nga ky komision dhe është përfunduar kjo çështje.

**z. Agim Mani:** Në Propozim Vendim ende përmendet emri i Rustem Zenuni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rustemit dorëheqja ju ka aprovuar. Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri Prezentë 27. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik, ashtu që në këtë komision emërohet për anëtar, Florina Lika –Vishi/Lënda: 01Nr.104/02-26512/24.**

**6. Kërkesa e MMPHI 6483-2/24 për Rishqyrtimin e Vendimit për miratimin e Planit të Veprimit në Mjedis me veprim klimatik i komunës së Kaçanikut 2024-2029 i datës 30.09.2024;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë, ministria e kas kthyer në rishqyrtim aktin e komunës dhe ua kemi dërguar juve për rishqyrtim. Ministria i ka potencuar çështjet ku duhet ndryshohet akti. Ministria ka kërkuar që plani të jetë 2025-2029. Jemi pajtuar me drejtorin me bërë këtë ndryshim. Të baza ligjore të ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, duhet thirrur në ligjin e ri, edhe për këtë jemi pajtuar. Të plani i realizimit të aktiviteteve, që mungojnë vlerat e projekteve, këtë çështje edhe ekspertët që kanë punuar planin, kanë thënë se askund nuk kemi mundur me gjetur në ligj se ka vlera konkrete të përcaktuara, por që ka periudha kohore të paraqitura në plan, ka kontrata afatshkurtër, afatgjata dhe afatmesme. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Qamil Stagova.

**z. Qamil Stagova:** Të parat të cilat i përmendi kryesuesi, janë çështje teknike, kurse të plani i realizimit të aktiviteteve, mungojnë vlerat e projekteve dhe viti i realizimit. Planin i veprimit në mjedis i komunës së Kaçanikut, diktohet nga plani i veprimit në mjedis nacional. Ky plan në vitin 2010 i ka dal afati dhe më asnjë qeveri nuk ka bërë plan tjetër. Në atë plan nuk janë diktuar çështjet e planit komunal të veprimit të mjedis. Është menduar me udhëzime dhe rregullore me u rregulluar kjo çështje, ndërkaq asnjë rregullor apo UA nuk është miratuar për këtë çështje, përmendja vlerës së projektit me euro, nuk është kërkesë që bazohet në ligj. Kurse në planin e veprimit në mjedis, projektet janë të ndara, projekte me kosto të ulët deri në 50 mijë euro, projekte me kosto të mesme, 50-300 mijë euro, projekte me kosto të lartë mbi 300 mijë

euro. Në lidhje me kohën e kryerjes së projekteve, janë shënuar projektet që kryhen në dy vitet e para në periudhë afatshkurtër, projektet që kryhen në vitet 3-4 afatmesme dhe projektet afatgjatë 5-6, mirëpo pasi plani është për 5 vjet, projektet afatgjatë mbetet të shënohen për 5 vjet. Mendoj se nuk ka bazë ligjore me kërkuar vlera të projekteve, ndërkaq kur të realizohen projektet, i kemi vlerat, se nuk është e bazuar në ligj që me i shënuar vlerat e projektit në plan.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Në emër të LDK, unë mendoj se nuk është dashur me u shfuqizuar. Sa i përket planit, unë mendoj se projekteve në plan nuk mundën me iu përcaktuar çmimet për shkak të lëvizjes së çmimeve ndër vite.

**z. Agim Mani:** Meqenëse ky është një vendim që është marrë në mbledhjen e kaluar, jo i bazuar, megjithatë edhe ne e përkrahim këtë plan të veprimit për ndryshim plotësim me rekomandimet e ministrisë. Plani hartohet në periudhë 5 vjeçare, viti 2024 jemi në fund dhe nuk të kemi plan për këtë vit. Baza ligjore duhet të thirret në ligjin e ri, se kjo përbën shkelje ligjore. Është bazike që ky plan të hartohet në bazë të legjislacionit aktual i cili ka kaluar disa filtra, përfshirë edhe KK. Plani i veprimit në mjedis, duhet të përmbaj vlerën e qartë të projekteve dhe aktiviteteve, përfshirë realizimin e kostove financiare. Këto detale e bëjnë planin me të kuptueshëm dhe me të zbatueshëm në praktikë. Me ndryshimin e këtyre rekomandimeve, plani do të jetë i zbatueshëm dhe ne do të përkrahim.

**znj. Ardita Rrahmani:** Në rregull, po e votojmë, por qysh me votuar diçka, kur to nuk e dinë se çka ka me ndodhur. Kush e ka mendua se ka me ndodhë pandemia, e kanë ndërruar mandej çmimet, që u përmend çështja e kostos.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe ligji e përcakton ashtu, nuk kemi me votuar me euro fikse, janë vlerat të cilat i parasheh ligji, janë vlera të ulëta.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është mirë me ditur cilit ligj me iu referuar në lidhje me këtë çështje. Si anëtarë të KK, ne është mirë me i shikuar ligjet.

**z. Agim Mani:** Ky plan është votuar njëherë, por është kthyer, se nuk ka qenë në rregull.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është votuar, por ne përsëri po merremi me këtë çështje. Ne duhet me ditur se çka po votojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ato që janë kërkuar, të emërtimi, viti duhet të jetë 2025-2029. Të baza juridike, aplikohet ligji i ri, të vlerat, ka me përcaktuar në kuadër të asaj si e përcakton ligji për vlera të ulëta, të mesme dhe të larta, të cilat i ceku drejtori edhe me shifra, edhe afatet kanë me qenë, afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për aprovimin e Planit të Veprimit në Mjedis me veprim klimatik i komunës së Kaçanikut 2025-2029/ Lënda; 01Nr. 104/02-27046/24/Lënda: 01 Nr. 104/02-27046/24.**

Me marrjen e këtij vendimi, anulohet Vendimi për aprovimin e planit të veprimit në mjedis 2024-2029 i datës 30.09.2024.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 13:10. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 27 anëtarët e KK-të gjithë.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit  
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik / Municipality of Kačanik



01 Nr. 060/01-28018/24  
Kačanik, 04.11.2024

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në pajtim me nenin 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Kuvendit të Komunës,

**PROPOZON**

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E SHKALLËVE TATIMORE PROGRESIVE NË PRONËN E  
PALUAJTSHME PËR VITIN 2025**

**Neni 1**

**Shkallet tatimore progresive**

1. **Cakton** shkallët tatimore progresive për vitin 2025 për vlerat e pronave në teritorin e Komunës së Kaçanikut, sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:
  - 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
  - 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni, **caktohet**;
  - 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
  - 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni dhe
  - 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

## **Neni 2**

### **Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

## **Neni 3**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2025.

### **Arsyetim**

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 i riformuluar me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20 e datës 16 gusht 2023 ,të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut.

Me dispozitat e cekura ligjore përcaktohet që Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit.

Nga të cekurat më lartë propozohet miratimi i këtij Propozim-Vendimi.

**KRYETARI I KOMUNËS**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-29265/24  
Kaçanik, 18.11.2024

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (c) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës 01Nr. 6/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 15.1(c) lidhur me nenin 55 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës të datës 13.11.2008, Kryesuesi i Kuvendit bënë këtë:

### PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me \_\_\_\_\_, 24, të merr këtë

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, në përbërje prej 7 anëtarëve, 6 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

|      |                |          |                   |
|------|----------------|----------|-------------------|
| 1.1. | Kemal Murseli, | kryesues | KK                |
| 1.2. | _____          | anëtar   | KK                |
| 1.3. | _____          | anëtar   | KK                |
| 1.4. | _____          | anëtar   | KK                |
| 1.5. | _____          | anëtar   | KK                |
| 1.6. | _____          | anëtar   | KK                |
| 1.7. | Makfire Malsiu | anëtar   | Zyra e Kryetarit. |

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi do të hartoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025 dhe për të njëjtin do t'i zhvilloj procedurat e nevojshme sipas rregullave ligjore në fuqi deri me miratimin e planit nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit; Kryetari i Komunës; Arkivi.

